

Projekti "Përkrahja e agro-bizneseve në Regjionin e Gjilanit", financuar nga Bashkimi Evropian dhe implementuar nga CARE Internacional, në partneritet me Komunën e Gjilanit dhe Qendra e burimeve për trajnim dhe lobim ATRC, shpallin

THIRRJE PËR APLIKIM PËR PUNË PRAKTIKE

Projekti ofron mundësinë për programin për punë praktike, për nxënësit e diplomuar të shkollave të mesme dhe universiteteve në të gjithë sektorët, që jetojnë në Regjionin e Gjilanit.

Përshkrimi i punës praktike

Sipas kriterëve të përcaktuara, projekti do të bëjë përzgjedhjen e 50 nxënësve ose studentëve të diplomuar që jetojnë në Regjionin e Gjilanit, të i'u ofrohet punë praktike në Kompanitë e përzgjedhura nga projekti, për 3 muaj me pagesë.

Në Kompanitë e përzgjedhura, nxënësit dhe studentët e diplomuar të profileve të ndryshme (bujqësore dhe të tjera) do të jenë në gjendje të ushtrorjnë njohurit e tyre në punë praktike.

Kriteret për aplikim

- Kandidati duhet të ofroj dëshmi për përfundimin e shkollës së mesme ose Universitetit si dhe dëshmi që jeton në Regjionin e Gjilanit.
- Kandidati duhet të jetë i gatshëm për punë praktike në periudhë prej 3 muaj.
- Përparësi do t'u ipen nxënësve ose studentëve të diplomuar me notë mesatare më të lartë.
- Përparësi do t'u ipen nxënësve ose studentëve të diplomuar me status ekonomik të ulët (qoftë nga zona rurale apo urbane).
- I/e diplomuar në Bujqësi apo Ekonomi do të kenë përparësi.

Koha dhe mundësia e aplikimit

Aplikacionet mund të merren në Qendrën për Përkrahje të Biznesit në Komunën e Gjilanit, në adresën si në vijim: Rruga. Bulevardi i Pavarësisë, nr. # 51, 60000 Gjilan/Gnjilane.

Afati për aplikim është **09 Dhjetor 2015**, ora **16: 00h**;

Aplikacionet duhet të dorëzohen tek Qendra për Përkrahje të Biznesit në Komunën e Gjilanit.

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit nuk merren parasysh.

Kandidati duhet të paraqes:

Me aplikacion duhet të bashkëngjiten edhe:

1. Forma e Aplikacionit e plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati.
2. Kopje e letërnjoftimit (kandidati duhet ta ketë me vete edhe origjinalin nëse kërkohet)
3. Certifikata e diplomimit të shkollës së mesme/universitetit.
4. Forma e plotësuar e CV, që mund të merret tek Qendra për Përkrahje të Biznesit në Komunën e Gjilanit.

Kandidatët që plotësojnë kriteret për aplikim dhe renditën në listën e ngushtë si kandidat potencial për intervistë, do të kontaktohen nga projekti. CARE mban të drejtën për të mos arritur numrin e plotë të kandidatëve të përzgjedhur për programin për punë praktike, në rast të cilësisë së ulët të aplikimeve.

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni Qendrën për Përkrahje të Bizneseve e-mail: **qendraperbiznes@hotmail.com**, Tel. **+377(0)45 529 390**

